



**RAPORTI VJETOR
I
INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
VITI 2022**

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|-----------|
| HYRJE..... | 1 |
| 1 ZBATIMI I KUADRIT LIGJOR | 4 |
| 1.1 KANDIDATË PËR ORGANET E SISTEMIT TË DREJTËSISË DHE PROCESI I RIVLERËSIMIT KALIMTAR..... | 4 |
| 1.2 REFORMIMI I SISTEMIT TË DEKLARIMIT TË INTERESAVE PRIVATË DHE KONTROLLI I PLOTË..... | 8 |
| 1.2.1 KONTROLLI I PLOTË DHE REZULTATET E KONTROLLIT.... | 11 |
| 1.3 ZBATIMI I LIGJIT NR. 60/2016 “PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”, I NDRYSHUAR | 12 |
| 2 REKOMANDIMET E GRUPIT TË SHTETEVE KUNDËR KORRUPTIONIT (GRECO V)..... | 16 |
| 3 FORCIMI I KAPACITETEVE DHE BASHKËPUNIMI NDËR- INSTITUCIONAL..... | 18 |
| 3.1 FORCIMI I KAPACITETEVE DHE ROLI NDËRGJEGJËSUES..... | 18 |
| 3.2 BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL..... | 21 |
| 4 PERFORMANCE FINANCIARE | 23 |
| 5 TRANSPARENCA INSTITUCIONALE..... | 26 |
| 6 PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE..... | 27 |
| 7 PRIORITETET PËR VITIN 2023 | 28 |
| ANEKSI NR. 1 | 30 |

HYRJE

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, gjatë periudhës raportuese, në përbushje të kompetencave ligjore për kontrollin e interesave privatë të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, në funksion të evidentimit, shmangjes e parandalimit të konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, si dhe të monitorimit të sinjalizimeve, është angazhuar maksimalisht në përbushjen e detyrave dhe përgjegjësive të tij funksionale.

Inspektorati i Lartë, ka vepruar në përbushje të detyrimeve ligjore, të përcaktuara në ligjet bazë, që rregullojnë veprimtarinë institucionale, si edhe ka përbushur plotësisht rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë, të paraqitura në rezolutën “*Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2021*”.

Për më tepër, në kuadër të angazhimeve të marra në procesin e integrimit evropian, Inspektorati i Lartë ka pasur në fokus të veçantë përbushjen e rekomandimeve të Komisionit Evropian, i cili në Raportin për Shqipërinë, të publikuar në muajin tetor 2022, në pjesën përfshirë kundër korruptionit rekomandon: “*Të adresojë në mënyrë efektive rekomandimet e GRECO dhe të zbatojë planin e veprimit.....*”, si dhe Rekomandimeve të Këshillit të Evropës.

Kështu, Inspektorati i Lartë në Raportin e Parë të Përputhshmërisë, të paraqitur në seancën e 92-të plenare të GRECO, u vlerësua që plotësoi në mënyrë të kënaqshme ose plotësisht të gjitha rekomandimet, të cilat kishin të bënin në mënyrë të drejtëpdrejtë dhe/ose të tërthortë me punën dhe veprimtarinë e institucionit.

Inspektorati i Lartë, gjatë vitit raportues vijoi procesin e koordinimit dhe mbështetjes me burimet e nevojshme institucionale, me qëllim vënien në funksionalitet të plotë të Sistemit Elektronik të Deklarimit të Interesave Privatë (EACIDS). Përtej sfidave dhe vështirësive të hasura në procesin e konsolidimit të sistemit, duke filluar nga data 31 tetor 2022, subjektit deklaruese, deklaruan interesat e tyre privatë në mënyrë elektronike.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë, në mbështetje të proceseve reformuese të sistemit të drejtësisë, bashkëpunoi ngushtësisht me organet e rivlerësimit kalimtar, si dhe me organet e emërtësës, në verifikimin e kandidatëve për organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë.

Inspektorati i Lartë, në përmbushje të objektivave kryesorë të veprimtarisë së tij, lidhur me ushtrimin e kontrollit të plotë dhe hetimin administrativ për vërtetimin e saktësisë dhe të dhënave të pasurive, të të ardhurave dhe detyrimeve të deklaruara nga zyrtarët dhe personat e lidhur me ta, përgjatë vitit raportues miratoi dhe kaloi në kontroll të plotë subjektet e përfshirë në skemën e kontrollit, si dhe ka asistuar Autoritetet Përgjegjëse/zyrtarët në dhënien e asistencës mbi trajtimin apo zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

Në zbatim të rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë për të krijuar instrumenta të qëndrueshëm, të cilët mundësojnë fuqizimin e rolit pro-aktiv në drejtim të monitorimit sistematik të Njësive Përgjegjëse për zbatimin efektiv të ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, ILDKPKI ka vijuar bashkëpunimin me institucionet publike për të evidentuar organizatat, të cilat kanë detyrimin e ngritisë së Njësive Përgjegjëse, si dhe ka mbajtur kontakte të vazhdueshme në asistencën e kërkuar nga njësitë përkatëse.

Në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional, me qëllim intensifikimin e bashkëpunimit të ndërsjelltë kundër korruptionit, Inspektorati i Lartë dhe Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korruptionit, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi në përmbushje të së cilës, u drejtuani dhe trajnuan disa raste në fushën e kompetencave institucionale. Përgjatë vitit raportues, në fokus ka qenë forcimi i urave të bashkëpunimit me SPAK, ku në kuadër të marrëdhënies ndër-institucionale janë trajtuar me përparësi të gjitha kërkuesat dhe janë vendosur në dispozicion dokumentacionet e kërkuaara.

Në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar, krahas vijimit të marrëdhënieve të ngushta dhe të frytshme me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, Këshillin e Evropës në Shqipëri, Zyrën e OSBE në Tiranë, Agjencitë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si USAID, Inspektorati i Lartë ka vijuar komunikimin dhe shtimin e kontakteve me zyrat homologe, apo agjencitë antikorruption në rajon dhe më gjerë, për të shkëmbyer eksperiencat dhe praktikat më të mira në këtë fushë.

Konkretnisht, vlen për t'u theksuar, nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis ILDKPKI dhe Agjencisë Kombëtare të Integritetit të Rumanisë (ANI), ku palët u angazhuan për të vlerësuar fushat me interes të përbashkët dhe për të punuar së bashku

në shkëmbimin e njohurive, eksperiencës dhe ekspertizës në implementimin e mekanizmave efektivë në rritjen e integritetit dhe transparencës.

Në vijim të marrëdhënieve ndërinstitucionale me Agjencinë Kombëtare të Integritetit në Rumania, Inspektorati i Lartë mori ftesën për të qenë anëtar me të drejta të plota në Rrjetin për Integritet (Network for Integrity), si një forum i rëndësishëm për shkëmbimin e përvojave të institucioneve të angazhuara në luftën kundër korruptionit, nga shtete të ndryshme, në rritjen e instrumenteve të integritetit dhe transparencës.

Për sa më sipër, Raporti Vjetor për vitin 2022, vjen si një dokument në të cilin, në mënyrë të plotë paraqitet një analizë e masave të marra në drejtim të përbushjes së rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimeve të lëna nga organizatat ndërkombëtare, kompetencave ligjore, rezultateve të arritura, si dhe prioriteteve institucionale.

1 ZBATIMI I KUADRIT LIGJOR

1.1 KANDIDATË PËR ORGANET E SISTEMIT TË DREJTËSISË DHE PROCESI I RIVLERËSIMIT KALIMTAR

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, përgjatë periudhës raportuese, ka vijuar mbështetjen e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke bashkëpunuar me organet e rivlerësimit në adresimin e kërkesave për vënie në dispozicion të dokumentacioneve për subjektet që po i nënshtrohen këtij procesi. Konkretilisht, gjatë kësaj periudhe janë trajtuar në total 63 kërkesa për dhënien e informacionit dhe dokumentacionit, brenda afateve të përcaktuara nga këto organe, si dhe 1 kërkesë nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë në përbushje të detyrimeve ligjore, si dhe rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë: “*Për të pasur prioritet të punës verifikimin e kandidatëve në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë*”, ka vijuar edhe përgjatë periudhës raportuese ushtrimin e kontrolleve të deklaratave të pasurisë për kandidatët në institucionet e sistemit të drejtësisë. Konkretilisht, u morën të gjitha masat e nevojshme për të përfunduar në një kohë sa më të shkurtër verifikimet **për 264 kandidatë** si më poshtë vijon:

- Në zbatim të Ligjit nr.115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë **për 17 kandidatë për gjyqtarë** në **Gjykatën Kushtetuese** dhe dërgimin pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të dosjes origjinale të kontrollit të plotë për secilin kandidat, në format elektronik (CD), raportin përfundimtar të kontrollit, së bashku me konkluzionet përkatëse.
- Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë, **për 11 kandidatë për gjyqtarë** në **Gjykatën e Lartë**, nga rradhët e gjyqtarëve dhe vendosi në dispozicion të Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktet e përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.

- ▣ Në zbatim të Ligjit nr. 95/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar Korruptionin dhe Krimin e Organizuar*”, i ndryshuar përfundimin e kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë, **për 29 kandidatë për hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit** dhe dërgimin pranë Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës për Prokurorinë dhe Gjykatat e Posaçme / Prokuroria e Posaçme Kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar, dokumentacionin e administruar nga korrespondenca me institucionet e specializuara, raportin përfundimtar të kontrollit, së bashku me konkluzionet përkatëse.
- ▣ Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë **për 1 kandidat për ngritje në detyrë për Gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit** dhe dërgimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të kandidatit së bashku me konkluzionet përkatëse.
- ▣ Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar si dhe të Vendimit nr.75, datë 23.5.2019, “*Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterieve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë*” përfundimin e kontrollit të plotë **për 4 kandidatë për gjyqtarë në Gjykatën e Apelit** dhe dërgimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të akteve të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të kandidatëve për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë.
- ▣ Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 75, datë 23.5.2019, “*Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterieve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë*”, përfundimin e kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë **për 45 kandidatë për programin e formimit fillestare për Magjistratë, profili Gjyqtar**, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin

akademik 2022 -2023 dhe dërgimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të akteve të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.

- Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë për **29 kandidatë për programin e formimit fillestar për Magjistratë, profili Prokuror**, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2022-2023 dhe dërgimin pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë të akteve të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.
- Në zbatim të Ligjit nr. 8577/2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese*”, i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë për **5 kandidatë për këshilltarë pranë Njësisë Ligjore në Gjykatën Kushtetuese** dhe dërgimin pranë Gjykatës Kushtetuese të akteve përfundimtare të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.
- Në zbatim të Ligjit nr. 98/2016 “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore, përfundimin e kontrollit të plotë për **4 kandidatë për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, për programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës** dhe dërgimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të akteve të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.
- Në zbatim të Ligjit nr. 95/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar Korruptionin dhe Krimin e Organizuar*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore, përfundimin e kontrollit të plotë për **46 kandidatë për Personel Administrativ të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar** dhe dërgimin pranë Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës për Prokurorinë dhe Gjykatat e Posaçme, të akteve të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.

- ♣ Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë për 8 kandidatë për Drejtues Prokurorie, të juridiksonit të përgjithshëm dhe dërgimin pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të akteve të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.
- ♣ Në zbatim të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, kandidatë si **Inspektorë** jo magjistratë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përfundimin e kontrollit të plotë për 18 kandidatë jo Magjistratë dhe dërgimin pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të akteve përfundimtare të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë e kandidatëve për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë.
- ♣ Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 75, datë 23.5.2019, “*Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë*”, përfundimin e kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë për 24 kandidatë magjistratë gjyqtarë, të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2021- 2022 dhe dërgimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të akteve të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të kandidatëve për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë.
- ♣ Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë për 22 kandidatë magjistratë prokurorë, të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2021- 2022 dhe dërgimin pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të akteve të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të kandidatëve për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë.

● Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjiqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë për 1 kandidat për Gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe dërgimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë.

1.2 REFORMIMI I SISTEMIT TË DEKLARIMIT TË INTERESAVE PRIVATË DHE KONTROLLI I PLOTË

Inspektorati i Lartë, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, i cili i hapi rrugën mundësisë së plotësimit dhe dorëzimit të deklaratave të interesave privatë në mënyrë elektronike, me qëllim jo vetëm modernizimin e sistemit të deklarimit të pasurisë, por edhe rritjen e eficiënsës dhe efikasitetit të kryerjes së kontrollit të deklaratave të interesave privatë për subjektet deklaruese, në gjashtë vitet e fundit ka qenë tërësisht i angazhuar në përgatitjen dhe ngritjen e sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë.

Sistemi elektronik i deklarimit të interesave privatë, ishte një hap tepër i rëndësishëm dhe reformues i ndërmarrë nga Inspektorati i Lartë me mbështetjen e vyer të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, si dhe produkt i një pune të madhe të bërë nga i gjithë ekipi që kontribuoi me ekspertizë dhe profesionalizëm në materializimin e tij.

Rrugëtimi drejt implementimit të këtij sistemi të ri ka qenë një proces tepër kompleks, i vështirë dhe jo pak sfidues. I nisur si përbushje e detyrimeve ligjore dhe angazhimeve të marra në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, rekomandimeve të dala nga Progres Raporti, GRECO dhe Kuvendi i Shqipërisë, ky mekanizëm synon të forcojë regjin e deklarimit dhe kontrollit të pasurive, rasteve të konfliktit të interesave, si dhe rritjen e transparencës institucionale.

Si një instrument novator, e vendosi Inspektoratin e Lartë në një fazë shumë të rëndësishme reformuese, që kërkon kohën e nevojshme për mirëfunksionimin, konsolidimin e proceseve, si dhe rritjen e kapaciteteve të të gjithë përdoruesve, me qëllim arritjen e rezultateve konkrete.

Në këtë drejtim, nuk kanë qenë të pakta sfidat në drejtim të familjarizimit të të gjithë përdoruesve me mënyrën e re të plotësimit, administrimit dhe dorëzimit të deklaratave; saktësisë në plotësimin e të dhënave nga të gjithë përdoruesit; bashkëpunimit ndërinstitucional për sigurimin e ndërlidhjes apo integrimit me sistemet e tjera publike/private, me qëllim shkëmbimin e informacionit të nevojshëm; garantimit të qëndrueshmërisë së mëtejshme të funksionimit të vet sistemit, si dhe sigurisë së informacionit në kuadër të sulmeve kibernetike.

Përtej sfidave dhe vështirësive, Inspektorati i Lartë mori të gjitha masat institucionale për funksionimin e plotë të sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë, ku në zbatim të dispozitave ligjore, të parashikuara në nenet 4/2, 21 dhe 42/2 të Ligjit nr. 9049/2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nepunësve publike*”, i ndryshuar, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës, hartozi dhe miratoi aktet e nevojshme nënligjore dhe formularët e deklarimit për sistemin elektronik.

Kështu, Inspektori i Përgjithshëm, me Urdhrin nr.925 dhe Urdhrin nr.926, datë 29.10.2021, miratoi përkatesisht formularët e deklarimit të interesave privatë në sistemin elektronik EACIDS. Njëkohësisht, u hartua dhe u miratua Udhëzimi i Inspektorit të Përgjithshëm nr. 927, datë 1.11.2021 “*Për mënyrën dhe procedurën e plotësimit të deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë në formë elektronike në sistemin elektronik për deklarimin e pasurive dhe konfliktit të interesave*”, i ndryshuar, në të cilin janë përcaktuar të drejtat dhe detyrat e aktorëve të përfshirë në procesin e deklarimit elektronik.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës, gjatë periudhës raportuese zhvilloi aktivitete trajnuese për Autoritetet Përgjegjëse pranë institucioneve publike, ku u trajnuan mbi 310 përfaqësues të autoriteteve përgjegjëse, si dhe u garantua asistencë për më shumë se 2000 subjekte deklaruese. Trajnimet e zhvilluara kishin synim rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të autoriteteve publike, të cilat janë përgjegjëse për menaxhimin e procesit të deklarimit të interesave privatë nga secili deklarues dhe personat e lidhur. Këto aktivitete shërbyen gjithashtu për të prezantuar pjesëmarrësit me sistemin elektronik dhe modulet kryesore të tij, si dhe për të ofruar informacione teknike me synim lehtësimin e procesit të deklarimit, përmes sistemit elektronik të deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave.

Për më tepër, më datë 28 shkurt 2022, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, Bashkimin Evropian dhe ILDKPKI në kuadër të programit “*Horizontal Facility II*”, u organizua Tryeza e Nivelit të Lartë “*Sistemi Elektronik i Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave – parandalimi i korruptionit nëpërmjet rritjes së transparencës së pasurive*”, ku ishin të pranishëm, Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Ambasadori i BE në Shqipëri, drejtues të Këshillit të Evropës, drejtues të SPAK, BKH, Prokurori i Përgjithshëm, Zëvendës Ministri i Drejtësisë, si dhe përfaqësues të institucioneve qendrore.

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, të gjithë subjektet deklaruase, deklaruan përmes sistemit elektronik EACIDS, brenda **31 tetor 2022**, deklaratat e interesave privatë, duke plotësuar tërësisht rekomandimet e lëna nga Kuvendi i Shqipërisë ndër vite, si dhe në Rezolutën e vitit 2022: **“Të marrë të gjitha masat institucionale për funksionimin e plotë të sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë, me fokus rritjen e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse për plotësimin e deklarimeve nga subjektet e ligjit në mënyrë të saktë”**.

Në përfundim të procesit, nga të dhënat e administruara në sistemin elektronik, rezulton se numri i deklaratave të administruara nga Inspektorati i Lartë për vitin 2022, është **3975 deklarata të interesave privatë**, nga të cilat, të ndara sipas llojeve të tyre, rezultojnë këto të dhëna statistikore:

- Deklarata Periodike Vjetore për Subjekte në Funksion (*për vitin deklarues 2021*)
– **2785 deklarata;**
- Deklarata Para Fillimit të Detyrës (2022) – **544 deklarata;**
- Deklarata Pas Largimit nga Funksioni (2022) – **438 deklarata;**
- Deklarata Kandidatë (2022) – **208 deklarata.**

Në vijim, Inspektorati i Lartë filloi procedurat për verifikimin e administrimit në mënyrë shkresore të të gjitha deklaratave të interesave privatë, si dhe kryerjen e përpunimit paraprak të të dhënave të paraqitura në deklaratat e interesave private.

1.2.1 KONTROLLI I PLOTË DHE REZULTATET E KONTROLLIT

Inspektorati i Lartë, krahas angazhimit në marrjen e të gjitha masave të nevojshme, si dhe adresimit të sfidave të rëndësishme në kuadër të vënies në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë, përgjatë periudhës raportuese, ka vijuar zbatimin e skemës së kontrollit të parashikuar nga neni 25/1 i Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*” i ndryshuar.

Në përbushje të objektivit të veprimtarisë së tij, lidhur me ushtrimin e kontrollit të plotë dhe hetimin administrativ për vërtetimin e saktësisë dhe vërtetësisë së të dhënavë të pasurive, të të ardhurave e detyrimeve të deklaruara nga zyrtarët dhe personat e lidhur me ta, konstatimin e rasteve të konfliktit të interesave, ka miratuar dhe ka kaluar në kontroll të plotë në **total 806 subjekte deklaruese**, si për shkak funksioni, ashtu edhe bazuar në informacione të ardhura nga burime të ligjshme.

Në këtë kuadër, Inspektorati i Lartë, në zbatim të nenit 44, të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar dhe nenit 40, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*.” i ndryshuar, ka aplikuar masën administrative “gjobë”, për rastet e refuzimeve për deklarim, si dhe për rastet e mosdeklarimeve dhe/apo për çështje të konfliktit të interesave. Për periudhën raportuese, janë në **total 128** masa administrative me “gjobë”. Për periudhën 2014 – 2022 janë aplikuar në total 2,017 masa administrative “gjobë”, të cilat në një pjesë të konsiderueshme janë lënë në fuqi nga Gjykata Administrative, apo janë ekzekutuar në mënyrë vullnetare.

Për më tepër, Inspektorati i Lartë, gjatë periudhës 2014 – 2022, ka referuar pranë Institucionit të Prokurorisë, strukturave të Hetimit Tatimor, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, si dhe Policisë së Shtetit, **555 subjekte**, në të cilat janë përfshirë zyrtarë të nivelit të lartë drejtues, si Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, Kryetarë Bashkie, Gjyqtarë, Prokurorë, Drejtore të Përgjithshëm, etj. Për periudhën raportuese janë paraqitur në **total 37 raste referimesh penale dhe referime të tjera**.

1.3 ZBATIMI I LIGJIT NR. 60/2016 “PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”, I NDRYSHUAR

Inspektorati i Lartë, në mbështetje të Rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë në Rezolutën për vitin 2022, në të cilën është kërkuar: *“Të krijojë instrumente të qëndrueshme në veprimtarinë e tij, që mundësojnë fuqizimin e rolit proaktiv në drejtim të monitorimit sistematik të njësive përgjegjëse për zbatimin efektiv të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar”*, ka vijuar të ketë kontakte të ngushta me Njësitë Përgjegjëse, me qëllim përbushjen e rekomandimit të lënë nga Kuvendi.

Në këtë drejtim, Inspektorati i Lartë, gjatë periudhës maj- qershori 2022, mori të gjitha masat e nevojshme për monitorimin dhe ngritjen e Njësive Përgjegjëse pranë institucioneve publike, në nivel qendror dhe vendor, të cilat kishin të punësuar mbi 80 punonjës. Gjatë këtij procesi, Inspektorati i Lartë bashkëpunoi ngushtësisht me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjen e të Dhënave Personale dhe Departamentin e Administratës Publike, si dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për të evidentuar institucionet publike, të cilat plotësonin kufirin e kërkuar nga dispozitat ligjore.

Me mbledhjen e informacionit të dërguar nga autoritetet publike, ILDKPKI përfundoi procesin e rishikimit të Regjistrat Kombëtar të Njësive Përgjegjëse në Autoritetet Publike, në të cilin janë pasqyruar të dhënat dhe funksioni i personave të ngarkuar për të zbatuar ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Nga të dhënat statistikore, rezulton se në total janë ngritur dhe funksionojnë **199 Njësi Përgjegjëse** në sektorin publik.

Për më tepër, Inspektorati i Lartë koordinoi punën me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për identifikimin e organizatave private, të cilat kishin të punësuar mbi 100 punonjës, për të vendosur kontaktet përkatëse për ngritjen e Njësive Përgjegjëse dhe raportimin e tyre pranë Inspektoratit. Në vijim të informacionit të marrë, u rishikuan dhe u përditësuan të dhënat e Regjistrat Kombëtar të Njësive Përgjegjëse në Sektorin Privat, në të cilin janë pasqyruar të dhënat dhe funksioni i personave të ngarkuar, për të zbatuar ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Nga të dhënat statistikore, rezulton se në total janë ngritur dhe funksionojnë **565 Njësi Përgjegjëse** në sektorin privat.

Në përfundim të procesit, për organizatat të cilat kishin detyrimin për krijimin dhe raportimin e Njësive Përgjegjëse, por që nuk e përbushën këtë detyrim brenda afateve ligjore të parashikuara nga Ligji nr.60/2016, “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*” i ndryshuar, u aplikua masa administrative “*gjobë*”, për rreth 20 organizata. Kështu për periudhën 2016 - 2022 janë aplikuar gjithsej 208 masa administrative “*gjobë*” ndaj organizatave, të cilat nuk kanë respektuar detyrimin për krijimin e Njësisë Përgjegjëse.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të parashikimeve të neneve 13 dhe 22, të Ligjit nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, i ndryshuar, brenda datës 15 janar 2023 ka pritur dhe administruar Raportet Vjetore të dërguara nga Njësitë Përgjegjëse, si nga autoritetet publike dhe nga organizatat private.

Në këtë kuadër, Inspektorati i Lartë ka marrë dhe administruar 178 raporte vjetore nga Njësitë Përgjegjëse pranë autoriteteve publike, nga të cilat rezulton se 151 Njësi Përgjegjëse kanë paraqitur raportet brenda afateve ligjore.

Në analizim të raporteve të paraqitura nga Njësitë Përgjegjëse konstatohet se, në 3 (tre) Njësi Përgjegjëse janë sinjalizuar dhe trajtuar raste, në kuadër të Ligjit nr. 60/2016, “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, i ndryshuar, si më poshtë:

- 1. Radio Televizioni Shqiptar:** Përgjatë vitit 2022 nga ana e Njësisë Përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, raportohen 3 (tre) raste sinjalizimi, të paraqitura me mjete të komunikimit elektronik dhe në mënyrë anonime. Për një prej rasteve të paraqitura janë kryer veprimet procedurale, administruar informacione dhe dokumente, dhe pas shqyrtimit, vlerësimi të pretendimeve është mbajtur procesverbal për “*Rekomandime dhe përmirësimin e punës*”, ndërsa në 2 (dy) rastet e tjera në përfundim të hetimit administrativ është vendosur “*Mosfillimi i hetimit administrativ*”.
- 2. Këshilli i Lartë Gjyqësor:** Gjatë vitit 2022 raporton se ka regjistruar 1 (një) rast sinjalizimi. Njësia Përgjegjëse për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Këshillin e Lartë Gjyqësor ka shqyrtuar përbajtjen e materialeve të sinjalizimit dhe në përfundim ka vendosur “*Mosfillimin e hetimit administrativ*”.

3. **Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural:** Gjatë vitit 2022 raportohen të kenë pasur 2 (dy) raste të sinjalizimit, për të cilat pas hetimit administrativ nuk kanë rezultuar të kenë pasur elemente të parashikuara nga ligji nr. 60/2016, “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, i ndryshuar.

Në lidhje me Njësitë Përgjegjëse pranë sektorit privat, janë marrë dhe administruar 261 raporte sinjalizimi nga të cilat rezulton se 229 Njësi Përgjegjëse kanë paraqitur raportet brenda afateve ligjore. Në analizim të raporteve të paraqitura nuk janë raportuar raste të sinjalizimit të regjistruara në këtë sektor.

Për sa i përket mekanizmit të jashtëm të raportimit, gjatë vitit raportues, Inspektorati i Lartë ka regjistruar dhe trajtuar në total **13 raste sinjalizimi dhe 2 kërkesa** për mbrojtje nga hakmarrja. Në analizim të rasteve të paraqitura, rezulton se kryesisht sinjalizimet janë paraqitur nëpërmjet postës elektronike, ku 12 raste sinjalizimi të jashtëm kanë ardhur nga sektori publik dhe 1 rast i përket sektorit privat.

ILDKPKI ka marrë masa për të regjistruar të gjitha rastet e sinjalizuara, në Regjistrin e Sinjalizimeve të Jashtme, në Regjistrin e Kërkesës për Mbrojtje nga Hakmarrja, si dhe ka hetuar administrativisht sinjalizimet e jashtme dhe kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja, në përpjekje me procedurën e përcaktuar në dispozitat e Ligjit nr. 60/2016, “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, i ndryshuar dhe Kodit të Procedurave Administrative, në respektim të afateve ligjore.

Në përfundim të hetimeve administrative, për procedurat të cilat kanë rezultuar të kryera në shkelje të kuadrit ligjor të zbatueshëm, është aplikuar një masë administrative me “*gjobë*” për ushtrim të funksionit në kushtet e konfliktit të interesave, si dhe në çdo rast është kërkuar ndaj titullarit të institucionit, marrja e masave për zgjidhjen e situatave të paligjshmërisë.

Për rastet e sinjalizuara, pas kryerjes së hetimeve administrative, janë vënë në dijeni edhe organet kompetente, sipas problematikave të ngritura nga sinjalizuesit, si vijon:

- ↳ Njoftim pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit për marrjen e masave për inspektim në lidhje me institucionin në varësi të tij;
- ↳ Njoftim pranë KLSH për auditim të fondeve publike;
- ↳ Njoftim për ndjekje të mëtejshme, strukturave të Policisë së Shtetit;
- ↳ Njoftim për ndjekje të mëtejshme nga Autoriteti Publik Qendror.

Lidhur me kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja, pas regjistrimit në Regjistrin e Kërkesës për Mbrojtje nga Hakmarrja, u zhvillua hetimi administrativ, në përputhje me procedurën e përcaktuar në dispozitat e Ligjit nr.60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, i ndryshuar dhe Kodit të Procedurave Administrative. Në përfundim të hetimit administrativ, rezultoi se nuk kishte ndodhur një akt hakmarrje e kryer nga organizata, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndaj sinjalizuesit.

Në lidhje me angazhimin e Inspektoratit të Lartë në procesin e përafrimit të Ligjit nr. 60/2016, “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, i ndryshuar me Direktivën (EU) 2019/1937, “*Për mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të ligjeve të Bashkimit Evropian*”, u garantua përfaqësimi në takimin e 8-të, të Komisionit Evropian për grupin e ekspertëve të angazhuar në këtë proces. Në këtë takim, ishin ftuar nga Komisioni Evropian përfaqësues të institacioneve të vendeve të ndryshme të BE për të prezantuar përdorimin e platformave të teknologjisë së informacionit për të implementuar lehtësimin e procesit të sinjalizimit. Këto prezantime u zhvilluan në funksion të evidentimit të platformave të dobishme, të cilat mund të vihen në përdorim në këtë fushë për të lehtësuar aksesin e sinjalizuesve, ruajtjen e anonimatit të tyre, si edhe ndjekjen në vijimësi të procesit të sinjalizimit.

Për më tepër, përgjatë vitit raportues, Inspektorati i Lartë vijoi përbushjen e angazhimeve të marra, në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me RAI, për projektin e financuar nga BE: “*Breaking the Silence: Enhancing the Whistleblowing Policies and Culture in Western Balkans and Moldova*” (Thyerja e heshtjes: Përmirësimi i politikave dhe kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe Moldavi). Kështu, ILDKPKI mori pjesë në një sërë aktivitetesh të organizuara nga RAI, mbi njohjen dhe

shkëmbimin e eksperiencave rajonale në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve, si dhe u angazhua në hartimin e raportit, mbi vlerësimin e përputhshmërisë së kuadrit ligjor në fuqi me Direktivën e BE, për mbrojtjen e personave që raportojnë. Raport, i cili përbën një bazë shumë të mirë për të vijuar procesin e përafrimit të legjislacionit të brendshëm me Direktivën e BE, si kërkesë në kuadër të procesit të integrimit në BE.

2 REKOMANDIMET E GRUPIT TË SHTETEVE KUNDËR KORRUPSIONIT (GRECO V)

Inspektorati i Lartë, në zbatim të rekomandimit të përcaktuar nga Kuvendi i Shqipërisë në Rezolutën e vitit 2022: *“Të adresojë në mënyrë të efektshme rekomandimet e lëna nga organizatat ndërkombëtare, përfshirë edhe rekomandimet e lëna në reportin e vlerësimit të Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës Kundër Korruptionit (GRECO) për përm bushjen e angazhimeve të ndërmarra në kuadër të proceseve integruese”*, ka marrë pjesë në grupet e punës lidhur me hartimin e Raportit të Përputhshmërisë, të paraqitur në seancën e 92-të plenare të GRECO, të zhvilluar në nëntor 2022, në Strasburg, për Raundin e Pestë të Vlerësimit të GRECO *“Parandalimin e korruptionit dhe promovimin e integritetit në qeverinë qendrore (funkcionet e larta ekzekutive) dhe agjencitë e zbatimit të ligjit”*.

Inspektorati i Lartë u vlerësua si institucioni që plotësoi në mënyrë të kënaqshme ose plotësisht, të tre rekomandimet të cilat kishin të bënин në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë me punën dhe veprimtarinë e tij dhe konkretisht lidhur me:

- Rekomandimi X: *“Të bëhet funksionale sa më shpejt të jetë e mundur, platforma elektronike e krijuar për deklarimin dhe publikimin e deklarimeve të pasurisë dhe interesit”*.

GRECO ka vlerësuar masat e marra në drejtim të testimit të sistemit, hartimit e miratimit të akteve ligjore e nënligjore, si dhe trajnimet me autoritetet dhe institucionet përgjegjëse përritjen e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e procesit të deklarimit të interesave privatë nga çdo deklarues dhe person i lidhur.

Në kuadër të masave të marra, nga data 1 janar 2022 është vënë në funksionim sistemi elektronik i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave, si dhe vijuan aktivitetet trajnuese në vitin 2022.

- Rekomandimi XI: “*Të sigurohen burimet e nevojshme ligjore, njerëzore, financiare dhe burime të tjera, në mënyrë që ILDKPKI të përmirësojë kapacitetin e tij për të kryer verifikimin efikas të deklarimeve të pasurive dhe interesave privatë*”.

Në raportin e GRECO theksohet se: “*Punonjësit e ILDKPKI kanë ndjekur disa trajnime për veprat penale në fushën e pastrimit të parave dhe hetimit finançiar. Në bashkëpunim me Programin e Mbështetjes Horizontale II të Këshillit të Evropës janë organizuar sesione trajnimi për verifikimin dhe hetimin e deklaratave të interesave privatë, duke synuar një këndvështrim krahasues me praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, në bashkëpunim me Agjencinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), është zhvilluar edhe një tjetër aktivitet trajnimi mbi praktikat më të mira për identifikimin, hetimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të lidhura me to. Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, ILDKPKI ka marrë pjesë në një aktivitet trajnimi të organizuar nga Nisma Rajonale Antikorrupsion (NRA) për njohjen dhe shkëmbimin e përvojave rajonale në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve. Burimet e përgjithshme financiare të akorduara nga buxheti i shtetit janë rritur me 37% nga viti 2019 deri në vitin 2021, si më poshtë: në vitin 2019 në vlerën 142,700,000 lekë (1,204,255 EUR), në vitin 2020 në vlerën 158,500,000 lekë (1,337,953 Euro), dhe në vitin 2021 në vlerën 195,944,00 lekë (1,653,585 Euro). Buxheti i alokuar për burimet njerëzore ka dëshmuar gjithashtu një rritje nga viti 2019 në 2021 si vijon: 985,000 Euro në vitin 2019; 1,002,166 Euro në vitin 2020 dhe 1,052,666 Euro në vitin 2021*”.

Për sa më sipër, GRECO ka mirëpritur alokimet nga buxheti i shtetit për ILDKPKI, të cilat kanë pësuar rritje të qëndrueshme ndër vite, si dhe përfitimin nga aktivitetet trajnuese të nëpunësve, duke inkurajuar autoritetet që të vazhdojnë të rrisin ekspertizën dhe aftësitetë e inspektorëve në të ardhmen. Në këtë kontekst, GRECO vlerëson se rekomandimi është përbushur plotësisht.

► Rekomandimi XII/ii: “*ii) të kryhet efektivisht bashkëpunimi i duhur me ILDKPKI për të rritur zbatimin efektiv të raporteve të ILDKPKI në rastet e shkeljes nga personat e besuar me funksione të larta ekzekutive dhe punonjësit e policisë të ligjeve për konfliktin e interesave dhe deklarimin e pasurisë*”.

GRECO ka vlerësuar nënshkrimin në muajin mars 2022 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis SPAK dhe ILDKPKI për rritjen e bashkëpunimit dhe forcimin e luftës kundër kimeve të kryera nga zyrtarët e lartë të administratës publike, të zgjedhurit dhe nëpunësit publikë, si dhe bashkëpunimin në pesëmbëdhjetë raste dhe shkëmbimin e informacionit. GRECO inkurajon dy institucionet të vazhdojnë të rrisin bashkëpunimin e tyre në të ardhmen.

Në vijim, Inspektorati i Lartë shpreh angazhimin për të bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse për Rekomandimin III) në të cilin parashikohet “*Harmonizimi dhe rritja e koherencës së natyrshme të kuadrit ligjor dhe institucional në luftën kundër korruptionit dhe integritetit të zyrtarëve publikë, veçanërisht në lidhje me personat me funksione të larta ekzekutive, për shembull, duke hartuar norma dhe rregullore në një manual dhe duke ofruar udhëzime mbi detyrimet e çdo kategorie dhe për rolin e çdo organi përgjegjës*”, si dhe Rekomandimin XXIV) që të sigurohet efektiviteti i zbatimit të ligjit për sinjalizuesit, duke përfshirë trajnimin dhe informimin e rregullt të stafit të policisë për masat e mbrojtjes së sinjalizuesve, me qëllim arritjen e vlerësimit të tyre si të plotësuara plotësisht, në raportin e dytë të përputhshmërisë për raundin e pestë.

3 FORCIMI I KAPACITETEVE DHE BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL

3.1 FORCIMI I KAPACITETEVE DHE ROLI NDËRGJEGJËSUES

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si institucion i pavarur, në zbatim të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve, dhe të disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar, Ligjet nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, si dhe Ligjet nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*” i ndryshuar, me synim, forcimin e

mëtejshëm të instrumenteve të hetimit administrativ, të deklarimit dhe kontrollit të pasurive, parandalimit e zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave të zyrtarëve, si dhe hetimit të rasteve të sinjalizimit, pas analizës së kryer, përçolli pranë Kuvendit të Shqipërisë propozimin për të realizuar ndryshimet në strukturën e tij organizative.

Propozimi për ndryshimet e strukturës kishte si qëllim përmirësimin e rolit dhe misionit të ILDKPKI, si një nga institucionet kryesore përgjegjëse në luftën kundër korruptionit, në zbatim të objektivave prioritare lidhur me:

- Përmirësimin e politikave dhe mekanizmave për kontrollin e interesave private.
- Parandalimin dhe shmangjen e konfliktit të interesave të zyrtarëve në përbushje të funksioneve publike.
- Verifikimin dhe hetimin administrativ të rasteve të sinjalizimit dhe trajtimit të kërkesave për mbrojtje nga hakmarrja.

Gjithashtu, propozimi për ndryshimin e strukturës së ILDKPKI, synoi përmirësimin e performancës institucionale, në përbushje të detyrimeve ligjore të lidhura me vënien në funksionim të “*Sistemit elektronik për deklarimin e pasurisë dhe konfliktit të interesit-EACIDS*”, të cilat kërkojnë njohuri të shtuara, si dhe rritje të kapaciteteve të nëpunësve të ngarkuar me mirëfunksionimin e sistemit elektronik të interesave privatë.

Për më tepër, në lidhje me rritjen e kapaciteteve institucionale në kuadër të hartimit të kërkesave buxhetore gjatë vitit raportues u kerkua një shtesë në buxhet në vlerën 33 milion lekë në zërin shpenzime dhe investime, si dhe në drejtim të rritjes së kapaciteteve të stafit, Inspektorë dhe Ndihmës Inspektorë, është garantuar pjesëmarrja në një sërë aktivitetesh trajnuese në bashkëpunim me partnerët kryesorë ndërkombëtarë.

Gjithashtu, me VKM nr.621 datë 28.9.2022 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.187, datë 8.3.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë të disa institucioneve të administratës publike”*”, të ndryshuar, trajtimi finansiar, konkretisht “*shtesa për kushte pune*”, u rrit me 150%.

Këto masa të marra përgjatë vitit raportues kanë përbushur plotësisht rekomandimin e Kuvendit në Rezolutën “*Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2021*”, ku në pikën 8 nxitet Inspektorati i Lartë të paraqesë në Kuvend nevojat për rritje të kapaciteteve

administrative dhe financiare me qëllim përbushjen e detyrave funksionale të ngarkuara nga kuadri ligjor në fuqi.

Në lidhje me angazhimin e kapaciteteve administrative në dhënien e asistencës së nevojshme, përfshirë udhëzime specifike, këshilla dhe trajnime organeve përgjegjëse të institucioneve shtetërore për zbatimin e saktë të dispozitave për konfliktin e interesave veçanërisht për evidentimin e saktë të deklarimeve rast pas rasti, si rekomandim i lënë nga Kuvendi, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në funksion të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve, dhe të disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, i ndryshuar në mënyrë periodike, por dhe rast pas rasti në bazë kërkesash, ka ofruar asistencë teknike dhe ligjore për Autoritetet Përgjegjëse apo funksionarët publikë.

Konkretilisht përgjatë vitit raportues, janë marrë dhe trajtuar më shumë se 30 kërkesa për dhënie asistence në identifikimin apo trajtimin e situatave të konfliktit të interesave, si dhe janë organizuar takime sqaruese për Autoritetet Përgjegjëse lidhur me çështjet institucionale apo individuale, të paraqitura për trajtim.

Për më tepër, Inspektorati i Lartë në përbushje të detyrimit ligjor, të parashikuar nga neni 42 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, ka administruar brenda afatit ligjor, raportet e dërguara nga çdo Autoritet Përgjegjës lidhur me veprimtarinë e kryer prej tyre në zbatim të ligjit, përfshirë edhe rastet e konfliktit të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklarimin periodik të interesave privatë.

ILDKPKI, gjatë vitit raportues ka qenë i angazhuar edhe lidhur me rritjen e kapaciteteve të Njësive Përgjegjëse pranë autoritetet publike të ngarkuara për zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, duke dhënë në mënyrë të vazhdueshme asistencë për çështje të parashtruara, lidhur me njohjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor.

3.2 BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, ka qenë një ndër prioritetet e Inspektoratit të Lartë gjatë vitit 2022, duke synuar dhe zbatimin e Rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë: *“Të intensifikojë bashkëpunimin ndërinstitucional me Koordinatorin Kombëtar Kundër Korruptionit, si dhe organet ligjzbatuese, në veçanti me SPAK, për të përmirësuar në mënyrë të efektshme ndjekjen e hetimeve administrative ose penale në drejtim të interesave privatë të deklaruar nga zyrtarët, të cilët janë subjekt i ligjit për deklarimin dhe parandalimin e konfliktit të interesave”.*

Në këtë kuadër, me qëllim intensifikimin e bashkëpunimit të ndërsjelltë ndaj luftës kundër korruptionit, me qëllim shkëmbimin e informacionit ndërmjet palëve, në lidhje me subjektet që mbartin detyrimin për deklarim në zbatim të Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nepunësve publikë*”, i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, ILDKPKI dhe Ministri i Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korruptionit, në datë 6 qershor 2022, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi. Në kuadër të marrëveshjes, gjatë kësaj periudhe, janë përcjellë dhe janë marrë për trajtim disa raste të përfshira në fushën e kompetencës së seilit institucion.

Për më tepër, në vijim të forcimit të bashkëpunimit me SPAK, me qëllim garantimin e plotësimit të strukturave me kapacitetet e nevojshme në burime njerëzore, Inspektorati i Lartë mori të gjitha masat për të kryer në kohë sa më shkurtër verifikimin e deklaratave të interesave privatë për kandidatët që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e BKH, si dhe personel administrativ pranë SPAK.

Gjithashtu, në vijim të mbështetjes së strukturave të SPAK mbi hetimet e nisura për zyrtarë të cilët janë subjekte të deklarimit të interesave privatë, ka vendosur në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshëm të administruar pranë Inspektoratit të Lartë për këta subjekte. Në kuadër të plotësimit të rekomandimit të dhënë në raportin e vlerësimit të GRECO V, është hartuar dhe është nënshkruar më datë 30 mars 2022, Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërinstitucional, ILDKPKI – SPAK. Në kuadër të marrëdhënies ndërinstitucionale gjatë periudhës raportuese janë marrë dhe trajtuar rreth

16 kërkesa nga struktura e posaçme duke vendosur në dispozicion dokumentacionet e kërkua brenda afateve kohore.

Në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar, krahas vijimit të marrëdhënieve të ngushta dhe të frytshme me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, Këshillin e Evropës në Shqipëri, Zyrën e OSBE në Tiranë, Agjencitë e Sheteteve të Bashkuara të Amerikës si USAID, Inspektorati i Lartë ka vijuar komunikimin dhe shtimin e kontakteve me zyrat homologe, apo agjencitë antikorruption në rajon dhe më gjerë, për të parë dhe aplikuar eksperiencat e tyre më të mira në këtë fushë.

Konkretilisht vlen për t'u theksuar, nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis ILDKPKI dhe Agjencisë Kombëtare të Integritetit të Rumanisë, më datë 21.9.2022 në Rumani, ku palët u angazhuan për të vlerësuar fushat me interes të përbashkët dhe për të punuar së bashku në shkëmbimin e njohurive, eksperiencës dhe ekspertizës në implementimin e mekanizmave efektivë në rritjen e integritetit e transparencës.

Në vijim të marrëdhënieve ndërinstitucionale me Agjencinë Kombëtare të Integritetit në Rumani, Inspektorati i Lartë mori ftesën për të qenë anëtare me të drejta të plota në Network for Integrity, si një forum i rëndësishëm për shkëmbimin e përvojave të institucioneve të ndryshme, nga kontinente të ndryshme, në rritjen e instrumenteve të integritetit, transparencës dhe etikës, si një mjet për të nxitur më tej besimin e publikut ndaj institacioneve publike.

Gjithashtu gjatë vitit raportues, Inspektorati i Lartë vijoi përbushjen e angazhimeve të marra, në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me RAI, për projektin e financuar nga BE “*Breaking the Silence: Enhancing the Whistleblowing Policies and Culture in Western Balkans and Moldova*” (Thyerja e heshtjes: Përmirësimi i politikave dhe kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe Moldavi). Kështu, ILDKPKI mori pjesë në aktivitetin e tretë trajnues të organizuar nga RAI, mbi njohjen dhe shkëmbimin e eksperiencave rajonale në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve. Në kuadër të këtij projekti, ILDKPKI ka kontribuar në hartimin e raportit, mbi vlerësimin e përputhshmërisë së kuadrit ligjor në fuqi me direktivën e BE, për mbrojtjen e personave që raportojnë. Ky raport do të ndihmojë Shqipërinë të harmonizojë ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve me Direktivën e BE, një kërkesë në kuadër të procesit të integrimit në BE.

Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me RAI, ILDKPKI, mori pjesë në nivel teknik në takimin rajonal “*Traktati Ndërkombëtar për Shkëmbimin e të Dhënave për*

Verifikimin e Deklaratave të Pasurive”, i cili u zhvillua në Podgoricë të Malit të Zi, në 20 dhjetor 2022. Qëllimi i Takimit Rajonal të Ekspertëve, ishte mbledhja së bashku e ekspertëve nga Evropa Juglindore të përfshirë në procesin e pranimit dhe verifikimit të deklaratave të pasurive dhe interesave, shkëmbimi i praktikave të mira nga Kroacia, Republika e Moldavisë dhe Ukraina, si edhe për të diskutuar hapat e ardhshëm në lidhje me zbatimin e Traktatit Ndërkombëtar.

Po kështu, gjatë vitit raportues, ILDKPKI ka marrë pjesë dhe ka dhënë kontributin e tij në takimet e zhvilluara nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), Sekretariati i Udhërrëfyesit Rajonal Antikorrupsion dhe Financave të Paligjshme për juridikSIONET e Ballkanit Perëndimor, së bashku me Zyrën Rajonale Kundër Korruptionit.

Konkretilisht, në këtë kuadër u zhvilluan një sërë takimesh, në datat 11-13 tetor 2022 në Dubrovnik, Kroaci, në 7-8 nëntor 2022 në Vienë të Austrisë, në 29-30 nëntor 2022 në Lubjanë të Sllovenisë. Këto takime u zhvilluan me qëllim vlerësimin e nivelit të realizimit të objektivave të përcaktuara në: “*Udhërrëfyesin kundër korruptionit dhe financimit të paligjshëm në Ballkanin Perëndimor*”, i cili u përgatit dhe u dakordësua nga vendet e Ballkanit Perëndimor, në takimin rajonal që u mbajt në Ohër në qershor të vitit 2021, si edhe koordinimi i konferencës rajonale kundër korruptionit, e cila u mbajt në Shkup në 14 dhjetor 2022. Konferenca Rajonale Kundër Korruptionit, e cila bëri bashkë anëtarët e nivelit më të lartë të qeverive nga juridikSIONET e Ballkanit Perëndimor, zyrtarë të lartë të qeverive, ekspertë teknikë kundër korruptionit, praktikues dhe përfaqësues të shoqërisë civile, kishte për qëllim mbështetjen e mëtejshme të juridikSIONeve të Ballkanit Perëndimor për të ecur përpara me Udhërrëfyesin Rajonal kundër korruptionit dhe financave të paligjshme për Ballkanin Perëndimor në kontekstin e procesit të Berlinit.

4 PERFORMANCE FINANCIARE

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2022, është mbështetur në kërkeshat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar, Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005

“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe Ligji nr. 60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, duke paraqitur një realizim të shpenzimeve buxhetore për vitin 2022, si më poshtë vijon:

Në mbështetje të Ligjit nr. 115/2021 *“Për buxhetin e vittit 2022”*, i ndryshuar, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është akorduar fondi buxhetor prej 191,479 milion lekë, i cili përbëhet nga:

- Fondi i pagave: 103,647 milion lekë;
- Fondi i sigurimeve shoqërore: 15,515 milion lekë;
- Shpenzime të tjera korrente: 38,107 milion lekë;
- Fondi për investime: 33,000 milion lekë;
- Transferime korrente: 1,210 mijë lekë.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të Ligjit nr. 115/2021 *“Për buxhetin e vittit 2022”*, i ndryshuar për periudhën e raportuar, Inspektorati i Lartë ka realizuar vlerën buxhetore në shumën 172,187 milion lekë ose 90% të fondit të planifikuar për 12 mujorin e vittit 2022.

ILDKPKI, referuar buxhetit të vittit 2022, ka zbatuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara, si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme, në mbështetje të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin dhe kontrollin financier”*, i ndryshuar.

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë këtij viti, numri i punonjësve ishte 70 punonjës, nga 70 punonjës të miratuar me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë, nr. 48, datë 22.7.2016 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 55/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”*, i ndryshuar.

Fondi i përgjithshëm i pagave, për këtë periudhë, është realizuar për numrin faktik të punonjësve në vlerën 95,443 milion lekë ose 92% e fondit të planifikuar për periudhën respektive dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 14,668 milion lekë ose 95% e fondit të planifikuar për periudhën respektive.

Për vitin 2022, janë kryer procedura rekrutimi në mbështetje të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në mbështetje të tij, për pozicionet vakante në kategorinë ekzekutive, të ulët, të mesme, si dhe në nivelin e lartë drejtues.

Për më tepër, në lidhje me fondin e planifikuar të investimeve për vitin 2022, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë u alohua si fond vlera prej 33,000 milionë lekë, nga i cili Inspektorati i Lartë, në mbështetje të procedurave të prokurimit publik, realizoi vlerën prej 25,482 milion lekë ose 77.22 % të fondit.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë vitit 2022, në realizimin e shpenzimeve operative, është mbështetur në kërkesa të cilat lidhen me:

- ✓ Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare, në funksion të një veprimtarie normale institucionale, të cilat për periudhën e raportuar janë realizuar në masën 100% të fondit të planifikuar vjetor;
- ✓ Realizimin e shpenzimeve për blerje materialesh e shërbimesh, sipas nevojave konkrete, për krijimin dhe përmirësimin e kushteve të punës në realizimin e një aktiviteti normal institucional;
- ✓ Forcimin e mekanizmave investigues për pasuritë e paluajtshme në terren dhe interesave privatë të zyrtarëve, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës teknologji – informacion.

Zëri i shpenzimeve operative për vitin 2022 u realizua në vlerën 35,644 milion lekë ose 95,28% e fondit të planifikuar për këtë periudhë, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

Gjatë këtij viti, shpenzimet buxhetore të domosdoshme, të planifikuara dhe të miratuara krahas prokurimit me tender, janë realizuar dhe procedurën blerje e vogël, sipas procedurës elektronike dhe janë lidhur kontrata në mbështetje të specifikimeve teknike, të sanksionuara në marrëveshjet dypalëshe. Shpenzimet e domosdoshme, të planifikuara dhe të miratuara gjejnë realizim, sipas nevojave konkrete të institucionit.

Të ardhurat nga veprimtaria e ILDKPKI për vitin 2022, kanë ardhur kryesisht nga arkëtimi i sanksioneve administrative me gjobë, të vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, gjatë zbatimit të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar; Ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016, “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, i ndryshuar, si dhe ekzekutimit të detyrueshëm nga Zyrat e Përmbarimit, për një vlerë totale prej 19,528,005 lekë. Këto të ardhura, në zbatim të VKM nr. 432, datë 28.6.2006 “*Mbi të ardhurat në institucionet buxhetore*”, kanë kaluar në Buxhetin e Shtetit, në masën 100%.

5 TRANSPARENCA INSTITUCIONALE

Inspektorati i Lartë në përbushje të rekandimit mbi forcimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile, median dhe publikun e gjerë për informacionet e dhëna për rastet e denoncimit të shkeljes së ligjit për deklarimin e interesave privatë pasurorë, për rastet e identifikimit të konfliktit të interesave, si dhe për rastet e dyshuara të korruptionit në sektorin publik dhe privat, ka marrë dhe trajtuar brenda afateve ligjore përreth 31 kërkesa si nga shoqëria civile dhe nga media.

Në këtë kuadër, Inspektorati i Lartë brenda afatit 10 ditor ka mundësuar publikimin e të dhënavës në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënavës personale, ku për periudhën 2014-2022 janë publikuar në total 66,204 deklarata, nga të cilat vetëm për vitin 2022 rezultojnë të publikuara 4271 deklarata të interesave privatë.

6 PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE

Inspektorati i Lartë për vitin 2022 në realizimin e performancës institucionale ka përbushur në tërësi rekomandimet e lëna nga Kuvendi i Shqipërisë, si dhe Organizatat Ndërkombëtare, kryesisht në drejtim të:

- Pasjes prioritet të punës verifikimin e kandidatëve në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë, ku gjatë periudhës raportuese janë verifikuar 264 kandidatë në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë, si për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, Gjyqtarë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatat e Apelit, Hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit, Magjistratë dhe dërgimin e akteve të kontrollit, së bashku me dosjet përkatëse pranë Këshillit të Emëritimeve në Drejtësi, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe organeve të tjera të emërtësës. Për më tepër, në kuadër të bashkëpunimit me organet e rivlerësimit kalimtar janë trajtuar në total 63 kërkesa për dhënien e informacionit dhe dokumentacionit shështë, brenda afateve të përcaktuara nga këto organe.
- Marrjen e të gjitha masave institucionale për funksionimin e plotë të sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë, me fokus rritjen e kapaciteteve të Autoriteteve Përgjegjëse për plotësimin e deklaratave nga subjektet e ligjit në mënyrë të saktë. Konkretilisht, u organizuan sesione trajnuese për 310 Autoritete Përgjegjëse, si dhe u adresuan të gjitha kërkesat për asistencë të paraqitura nga subjektet deklarues, duke përmbyllur procesin e deklarimit brenda datës 31 tetor 2022.
- Rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional me Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit, si dhe organet ligjzbatuese, në veçanti me SPAK, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit, ku janë trajtuar raste, kërkesa dhe dokumentacion në fushën e kompetencës së secilit institucion.
- Përbushjen në mënyrë të efektshme të rekomandimeve të lëna në reportin e vlerësimit të Grupit të Shteteve Kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës (GRECO) në raundin V, ku në reportin e parë të përputhshmërisë, Inspektorati i Lartë u vlerësua si institucioni që plotësoi në mënyrë të kënaqshme ose plotësisht të tre rekomandimet, të cilat kishin të bënin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë me punën dhe veprimtarinë e tij.

- Zbatimin me rigorozitet të skemës së kontrollit të plotë, ushtrimin e kontrollit të plotë dhe hetimit administrativ për vërtetimin e saktësisë dhe vërtetësisë së të dhënave të pasurive, të ardhurave e detyrimeve të deklaruara nga zyrtarët dhe personat e lidhur me ta, konstatimin e rasteve të konfliktit të interesave, për 806 subjekte deklaruese.
- Ndëshkimin e subjekteve të gjetura në shkelje të kuadrit ligjor, duke aplikuar 128 masa administrative “*gjobë*” dhe depozituar 37 referime penale dhe referime të tjera pranë institucionit të Prokurorisë, strukturave të Hetimit Tatimor, si dhe strukturave të Policisë së Shtetit.
- Angazhimin në zbatimin e Ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, i ndryshuar, duke marrë masa në drejtim të monitorimit të ngritisës së Njësive Përgjegjëse pranë organizatave publike dhe private, si dhe aplikimin e masave administrative me “*gjobë*” për organizatat e gjetura në shkelje të detyrimeve ligjore. Për më tepër, në drejtim të hetimit të rasteve të sinjalizimit janë marrë masa për hetimin si mekanizëm i jashtëm raportimi për 13 raste sinjalizimi dhe 2 kërkesa për mbrojtje nga hakmarrja.
- Angazhimin e kapaciteteve administrative në dhënien e asistencës së nevojshme, përfshirë udhëzime specifike, këshilla dhe trajnime organeve përgjegjëse të institacioneve shtetërore për zbatimin e saktë të dispozitave të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, duke ofruar mbështetje për Autoritetet Përgjegjëse.
- Ndjekjen e një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile, ku të gjitha kërkesat e paraqitura për publikim të deklaratave të interesave privatë, janë trajtuar në përputhje me afatet ligjore, gjë që ka rezultuar në publikimin e rreth 4271 deklaratave të interesave privatë, gjatë vitit 2022.

7 PRIORITETET PËR VITIN 2023

- Garantimi i funksionalitetit të plotë të Sistemit Elektronik të Deklarimit të Interesave Privatë, duke synuar rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të Autoriteteve Përgjegjëse, si dhe marrjen e masave të nevojshme ligjore dhe institucionale për garantimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së informacionit.
- Në zbatim të kërkesave ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të*

zgjedhurve, dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 60/2016, datë 2.6.2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar vazhdimi i ndjekjes dhe implementimi i skemës së kontrollit të deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë të subjekteve deklaruese, si dhe monitorimi i Njësive Përgjegjëse në regjistrimin dhe hetimin e rasteve të sinjalizimit.

- Forcimi i bashkëpunimit me institucionet vendase dhe ndërkontrolltare për të përbushur të gjitha rekomandimet, të cilat do të hartohen në përfundim të takimeve dypalëshe për harmonizimin e legjisacionit të brendshëm me *acquis communautaire*, me fokus proceset e integrimit evropian.
- Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional do të vazhdojë intensifikimi i bashkëpunimit me organet ligjzbature si një element i domosdoshëm në drejtim të garantimit të sigurisë dhe efektivitetit të kontolleve dhe hetimeve administrative, për ruajtjen e standardeve në luftën kundër korruptionit dhe krimit ekonomik.
- Në zbatim të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, përbushja e kompetencave në kuadër të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, në bashkëpunim me Agjencinë e Mbikqyrjes Policore.
- Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet anëtarësimi të institucionit në Rrjetin për Integritet (Network for Integrity), si një nga priorititetet e institucionit për marrjen e masave konkrete në nivel ndërkombëtar në lidhje me luftën kundër korruptionit dhe zhvillimin e mekanizmave të cilët garantojnë integritet.
- Ndjekja e një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile në përbushje të kërkesave për informacion, në respektim të kuadrit ligor për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

ANEKSI NR. 1

Inspektorati i Lartë, në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë, nr. 49/2017 “*Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj*”, si dhe Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 134/2018, datë 20.12.2018 “*Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik*”, për çështjet e përfshira në planin e veprimit, parashtron sa më poshtë vijon:

A-Niveli i zbatueshmërisë së rekomandimeve të institucioneve të pavarura nga ekzekutivi gjatë periudhës së raportimit

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatim të kuadrit ligjor, Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar, Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, i ndryshuar ka në kompetencë të tij, sanksionimin me anë të masave administrative “*gjobë*” për shkelje të konstatuara të dispozitave ligjore, nga subjektet deklaruese apo Njësitë/Autoritetet Përgjegjëse.

Për të gjitha masat administrative “*gjobë*”, Inspektorati i Lartë ka ndjekur rrugët ligjore për të garantuar vënien e tyre në ekzekutim vullnetar ose të detyrueshëm nga ana e subjekteve të sanksionuara.

B- Pasqyrat financiare, audit i brendshëm dhe/ose i jashtëm, statusi i ankimeve gjyqësore, kallëzimet penale, plani i veprimit të institucionit, raport ose informacion mbi zbatimin e ligjit të shërbimit civil dhe eficiencës së rritjes së kapaciteteve njerëzore në funksion të misionit të institucionit.

- Audit i brendshëm dhe/ose i jashtëm

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave nuk ka njësi të auditit të brendshëm. Për vitin 2022, ILDKPKI nuk ka qenë e përfshirë në planin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, por ka qenë pjesë e procesit të vlerësimit

të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm nga Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (DH/MFKK), si drejtori përgjegjëse për monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Kontrolli u zhvillua në përputhje me “*Metodologjinë e Vlerësimit të Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, miratuar me Urdhër nr. 311, datë 23.12.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Objektivat e vendosur lidhur me këtë vlerësim ishin:

- ✓ Verifikimi nga ana e DH/MFKK e gjendjes së zhvillimit të sistemit të kontrollit të brendshëm (KB), duke ekzaminuar bazën dokumentare sipas secilës rubrikë të listës së kontolleve;
- ✓ Vlerësimi i efektivitetit dhe eficiencës së këshillave dhe rekomandimeve të adresuara për subjektin e vlerësuar.

Vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave u mbështet në listën e kontolleve dhe dokumentacionet që e shoqërojnë atë, pyetësorin e vetëvlerësimit, planin e veprimit të MFK, raportin vjetor për vlerësimin e sistemit të KB.

Në përfundim të kontrollit rezultoi se: Sistemi i kontrollit të brendshëm në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave vlerësohet efektiv, me 54 pika të plotësuara nga lista e kontolleve të shoqëruar me dokumentacion justifikues.

- **Plani i veprimit të institucionit**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, mbështet planin e veprimit të institucionit në zbatim të objektivave prioritarë në drejtim të:

- Vënies në funksionalitet të plotë të sistemit të deklarimit elektronik të interesave privatë, ku në këtë drejtim gjatë vitit raportues u morën të gjitha masat e nevojshme për të garatuar procesin e plotësimit dhe dorëzimit të deklaratave me anë të këtij sistemi.

- Zbatimit të skemës së kontrollit të deklaratave të interesave privatë, përcaktuar nga neni 25/1, i Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar, duke kryer kontrollet e deklaratave të interesave privatë të subjekteve, në përputhje me kërkeshat e Ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.
- Verifikimit dhe hetimit të deklaratave të pasurive të kandidatëve për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, në zbatim të nenit 3/1 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar.
- Hetimit dhe verifikimit të rasteve të paraqitura në kuadër të Ligjit nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, i ndryshuar, si dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me Autoritetet Përgjegjëse dhe Njësitë Përgjegjëse, si njësi të angazhuara me funksione për zbatimin e Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve, dhe të disa nëpunësve publikë*” i ndryshuar, Ligjet nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*” i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, i ndryshuar.
- Pasqyrat financiare

TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI

| Llog Ek | Përshtküimi | Plan-Buxheti vjetor 2022 | Plan-Buxheti vjetor i ndryshuar 2022 | Plan-Buxheti 12 -mujori 2022 | Buxheti I realizuar 12 mujori 2022 | Realizimi në % si 12 mujor |
|--------------|-----------------------------------|--------------------------|--------------------------------------|------------------------------|------------------------------------|----------------------------|
| 600 | Fondi Paga | 110,920 | 103,647 | 103,647 | 95,443 | 92% |
| 601 | Kontrib. Sig Shoq&Shëndetësore | 15,400 | 15,515 | 15,515 | 14,668 | 95% |
| 602 | Shpenzime operative | 36,384 | 38,107 | 38,107 | 35,644 | 94% |
| 606 | Transferta për financime të tjera | 240 | 1,210 | 1,210 | 950 | 79% |
| 231 | Investime | 33,000 | 33,000 | 33,000 | 25,482 | 77% |
| Shuma | | 195,944.00 | 191,479.00 | 191,479.00 | 172,187.00 | 90% |

- Statusi i ankimeve gjyqësore, kallëzimet penale

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, gjatë vitit raportues, ka aplikuar gjithsej **128 sanksione**, masë administrative me “*gjobë*”, për mosdeklarim të interesave privatë, konfliktit të interesave, si dhe për shkelje të Ligjit nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, i ndryshuar. Nga këto, janë ankimuar pranë organeve gjyqësore vetëm **21 vendime**, prej të cilave, deri në momentin e raportimit, gjykata ka vodosur në mbështetje të vendimeve të marra nga ILDKPKI, për **6 vendime**. Për më tepër, për **13 vendime** masë administrative *gjobë*, që i përkasin viteve të mëparshme, kanë përfunduar gjykimin gjatë vitit 2022, duke u vodosur lënia në fuqi e masës administrative të dhënë nga ILDKPKI.

Njëkohësisht janë marrë masa nëpërmjet organeve përbirimore për vënien në ekzekutim të vendimeve, lidhur me sanksionet administrative “*gjobë*”, ku për vitin raportues rezulton të jenë vënë në ekzekutim **33 vendime**, prej të cilave, **11 vendime** i përkasin sanksioneve të vodosura përgjatë vitit 2022. Për t'u theksuar është fakti se në **38 raste**, shlyerja e detyrimit është kryer në mënyrë vullnetare, nëpërmjet pagesave nga subjektit e sanksionuara.

- **Informacion mbi zbatimin e ligjit të shërbimit civil dhe eficiencës së rritjes së kapaciteteve njerëzore, në funksion të misionit të institucionit.**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ka përbushur detyrimet që burojnë nga Ligji nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe Kodit të Punës për punonjësit mbështetës. Nëpërmjet Njësisë Përgjegjëse, janë mbikëqyrur dhe menaxhuar burimet njerëzore, duke respektuar parimet kryesore të këtij legjislacioni, si dhe janë kryer vlerësimet e rezultateve në punë të punonjësve dhe procesi i vlerësimit të performancës së tyre, në përputhje me afatet ligjore brenda periudhës 6 mujore.

Për vitin 2022, janë kryer procedura rekrutimi, në mbështetje të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në mbështetje të tij, për pozicionet vakante, për 1 (një) vend për pozicione në kategorinë e ulët drejtuese, për 1 (një) vend për pozicione në kategorinë e

mesme drejtuese, 5 (pesë) vende për kategorinë ekzekutive, si dhe 2 (dy) vende për pozicione në kategorinë e lartë drejtuese, në ILDKPKI.

C- Zbatimi i masave specifike të dala nga rekomandimet e instrumenteve ndërkontëtarë, ku Shqipëria është shtet anëtar dhe të raporteve të Komisionit Evropian

Inspektorati i Lartë, gjatë periudhës raportuese ka vijuar aktivitetin institucional duke pasur në fokus rekomandimet e drejtuara Republikës së Shqipërisë nga GRECO, në Raundin e Pestë të Vlerësimit për Shqipërinë që trajton: “*Parandalimi i korruptionit dhe promovimi i integritetit në pushtetin qendror (funkcione të larta ekzekutivi) dhe në agjenci ligjzbatusë*”.

Në Raportin e Parë të Përputhshmërisë, i cili vlerëson masat e marra nga autoritetet e Shqipërisë për të zbatuar rekomandimet e nxjerra në Raportin e Vlerësimit të Raundit të Pestë, ILDKPKI për të gjitha rekomandimet, të cilat kishin të bënин në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë me punën dhe veprimtarinë e tij, u vlerësuan si të zbatuara në mënyrë të kënaqshme.

Për më tepër, me marrjen e vendimit për hapjen zyrtare të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ILDKPKI ka qenë tërësisht i angazhuar për plotësimin e kërkeseve mbi përgatitjen dhe finalizimin e materialeve për takimin dypalësh BE-Shqipëri, në kuadër të Kapitullit 23 “*Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore*”, si dhe adresimin e çështjeve të parashtruara gjatë këtij takimi nga përfaqësuesit e lartë të BE.

Ju faleminderit !